Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 18
Datë: 05.02.2014

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve bazuar në nenin 4 me pikat 1,3,6,9 dhe nenit 5 të pikave 1,2,3 të Rregullores së punës për Këshillin Drejtues të AKK-së, si dhe në mbështetje të nenit 14, 15, 16, 17 të kësaj rregullore, si dhe duke u mbështetur në Ligjin për Kualifikimet Kombëtare (nr. 03- L 0600), neni 10, neni 21.3 neni 22, si dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2011, miratuar nga MASHT mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritet Kombëtar i Kualifikimeve nxjerr:

VENDIM

1. Aprovohet procesverbali nga mbledhja e kaluar;
2. Aprovohet fillimi i fazës së validimit të kualifikimeve dhe akreditimit të ofruesve për këto sektorë dhe profile:

   Sektori i bujqësisë- profili Teknik i Bujqësisë

   Sektori i veterinarisë- profili Teknik i Veterinarisë

   Sektori i shëndetësisë- profilet

   Audiometrist

   Teknik i dentar

   Teknik i ortoprotetikës

   Teknik i optikës

   Asistent i ortopedisë

3. Aprovohet lista dyvjeçare e ekspertëve të jashtëm për procesin e validimit të kualifikimeve dhe akreditimin e ofruesve të arsimit dhe aftësimit profesional nga sektori i Shkencave Sociale për profilin Lidershipi dhe puna me të rinjtë në komunitet.

4. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve është i obliguar që varësisht nga nevojat dhe kërkesat të përzgjedhë këta ekspertë nga kjo listë dyvjeçare.

5. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

6. Vendimi të gjitha palëve të interesit

Kryetari i KD së
AKK-së
Ragip Gjoshi